



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria e Bujqësisë

PÛRKRAHJA E FERMERËVE PÛR KULTIVIMIN E PEMËVE TË IMËTA

Furnizimi i fermerëve me fidanë të mjedrave

Qëllimi:

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të planit zhvillimor në lëmin e bujqësisë, një rëndësi të veçantë i ka kushtuar përkrahjes së pemëtarisë, me prioritet për përkrahjen e sektorit të kultivimit të pemëve të imëta. Në kuadër të kësaj përkrahjeje kultivimi i mjedrave, përkatsisht rritja e sipërfaqeve me këtë kulturë, është njëra nga prioritetet, pasi që karakterizohet me një produktivitet të lartë, e njëkohësisht edhe me një levërdi ekonomike.

Mënyra e përkrahjes dhe kontributi i fermerëve në projekt.

- Planifikohet furnizimi i fermerëve me fidanë të mjedrës;
- Do përkrahen gjithsej 15 fermerë me nga 4000 fidanë mjedër për fermer;
- Furnizimi me fidanë të mjedrave do bëhet nga vetë fermerët – përfituesit, në entitete që janë të licencuara për prodhimin apo tregtimin e varietetit të kërkuar të mjedrës;
- Përfituesit e fidanëve duhen të kenë burimin e ujit.

Investim në sistemin e ujitjes, sipas këtij përshkrimi:

- Gyp furnizues Ø40, 50 m;
- Gyp pikë – pikë Ø16, distanca mes pikatoreve 20 cm (me nga dy pikatore), 3300 m;
- Ventur për ushqim të mjedrave, 1 copë;
- Filter Ø40 për filtrim të ujit, 1 copë;
- Mbyllëse 33 copë;
- Valvula (konektorë) 33 copë.

Përfituesi obligohet t'i bëjë analizat e tokës në laborator të licencuar në fushën përkatëse, për ato parcela ku planifikohet mbjellja e mjedrave dhe njëkohësisht të prezantojë (dëshmojë) rezultatet e analizave;

Fermerët e kualifikuar për furnizim me fidanë janë të obligura që të përcjellin të gjitha trajnimet e nevojshme për kultivimin e mjedrës;
Pagesa do të bëhet pas konstatimit të organit përkatës komunal, pasi të jenë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara;
Përfituesi duhet të sjellë faturën për blerjen e fidanëve të mjedrës;
Pas furnizimit me fidanë dhe mbjelljes së tyre nga ana e përfituesit, do të realizohet pagesa në vlerën prej 0.60 €, për një fidan mjedër;
Vlera që do të paguhet është 2,400.00 € për një fermer;
Vlera e projektit është 36,000.00 € .

Kriteret e përcaktuara:

1. Përkrahen fermerët për mbjelljen e mjedrës në sipërfaqe prej 0.50 ha;
2. Fermerët duhet të kenë mundësi të ujitjes (burimin e ujit);
3. Duhet të investojnë në vendosjen e sistemit të ujitjes pikë – pikë;
4. Fermerët e përzgjedhur janë të obliguar që të bëjnë analizën e tokës - parcelës që do ta mbjellin me mjedër dhe nëse këto analiza tregojnë se ajo parcelë nuk i plotëson kriteret për kultivimin e mjedrës, atëherë përfituesi (përfituesja) do të refuzohet;
5. Përparësi do të kenë fermerët që kanë njohuri profesionale në lëmin e bujqësisë (diplomë, dëshmi mbi trajnimet për kultivimin e mjedrave, e të ngjashme) dhe që shprehin gatishmëri për pjesëmarrje në trajnime intensive për mënyrën e kultivimit të mjedrës;
6. Po që se ka më shumë aplikues sesa numri i përfituesve, e që i plotsojnë kriteret në të njëjtën masë, atëherë do aplikohet kriteri “ I pari vijen , i pari shërbehet”;
7. Përfituesi nuk mund të jetë në marrëdhënie pune me institucionin (Komunën) që e bën përkrahjen;
8. Nuk përkrahen fermerët që kanë qenë përfitues për ngritjen e sipërfaqeve me pemë të imëta-mjedër;
9. Përfituesi duhet të jetë banorë, si edhe të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës.

Dokumentacionet e nevojshme:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin për llogarinë bankare;

- Certifikata mbi prinësinë e paluejtshme, me afat deri në një vit;
- Kopjen e planit;
- Raporti mbi rezultatin e analizës së tokës.

Koha dhe vendi i mbjelljes.

Mbjellja e mjedrës duhet të bëhet në vjeshtë.

Kultivimi i mjedrës do të bëhet në tërë territorin e komunës së Prishtinës.

Aplikuesit, parcelat e të cilëve pas analizave të bëra konstatohet se nuk janë të përshtatshme për kultivimin e mjedrave, do të refuzohen edhe nëse i plotsojnë të gjitha kriteret e tjera.

Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.